



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin Evropian

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 07.07.2015, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Majlinda Bregu - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
2. Hartimi dhe miratimi i kalendarit të punës së komisionit për periudhën 3-23 korrik 2015.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian për punësimin dhe inovacionin social (EASI)”.
4. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Majlinda Bregu, Taulant Balla, Bujar Derveni, Esmeralda Shkja, Gerti Bogdani, Sadri Abazi dhe Ilir Xhakolli.

Mungojnë:

Arben Imami, Edi Paloka, Gramoz Ruçi,

Të ftuar:

Bardhylka Kospiri - zëvendësministre e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Kledia Mazniku - drejtoreshë e Shërbimit Juridik në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Stela Ademi – përfaqësuese e Ministrisë së Integritit.

Dedë Kasneci - drejtor i Njesisë së Përafrimit të Legjislacionit të Kuvendit.

HAPET MBLEDHJA

Majlinda Bregu - Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Sot në rendin e ditës kemi:

- Miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
- Hartimin e kalendarit të punës së komisionit për periudhën 3-23 korrik 2015.
- Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian për punësimin dhe inovacionin social (EASI)”.

- Diskutimin për takimin e radhës për COSAP-in, presidencën e të cilit Shqipëria e mban që nga muaji mars.

Për projektligjin janë të pranishëm në komision: zonja Bardhylka Kospiri, zëvendësministre e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Kledia Mazniku, drejtoreshë e Shërbimit Juridik në këtë ministri, Stela Ademi nga Ministria e Integritit dhe si gjithmonë, Dedë Kasneci, nga Njësia e Përafrimit të Legjislacionit të Kuvendit.

Mirë se erdhët!

Fjala është për ju, zonja zëvendësministre!

Fare shkurt të na sqaroni ju lutem, për gjërat e reja dhe ndryshimet që sjell projektligji, që ju mendoni se duhet të jenë patjetër në vëmendje të këtij komisioni, sepse kemi edhe opinionin e Njesisë së Përafrimit të Legjislacionit të Kuvendit. Pra, një shpjegim të shkurtër të ndryshimeve që sjell.

Bardhylka Kospiri – Faleminderit!

E nderuar, zonja kryetare,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Miratimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian për punësimin dhe inovacionin social (EASI)”, sigurohet pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë program, duke përfutur mbështetje financiare në nivel kombëtar në fushat e punësimit dhe çështjeve sociale, për të zhvilluar sisteme adekuate të mbrojtjes sociale dhe politikave të tregut të punës, duke promovuar qeverisjen e mirë, të mësuarit reciprok dhe inovacionin social.

Shqipëria, si vend kandidat, do të mund të përfitojë 2 nga 3 akset e këtij programi, një prej të cilit është aksi “Progres”, i cili do të mbështesë përmirësimin e politikave në 3 seksione tematike, në punësim dhe veçanërisht, për të luftuar papunësinë e të rinjve, mbrojtjen sociale, përfshirjen sociale, uljen e varfërisë dhe përmirësimin kushteve të punës, bazuar në 4 objektiva, të cilat janë:

- Zhvillimi dhe përhapja me cilësi të lartë e njohurive analitike;
- Vlerësimi objektiv dhe gjithëpërfshirës në shkëmbimin e informacionit;
- Sigurimi i mbështetjes financiare për të promovuar rrishtë e politikave sociale dhe ato të tregut të punës;
- Sigurimi i organizatave me mbështetje financiare, për të rritur kapacitetin e tyre për të zhvilluar promovimin në mbështetjen e zbatimit të instrumenteve të politikave të BE-së.

Aksi i dytë është “Mikrofinanciar dhe ndërmarrja sociale”, që mbështet veprimet në 2 seksione tematike: mikrokredi për grupet e cenueshme, si dhe mikrondërmarrje dhe sipërmarrje sociale, që bazohen në 3 objektiva:

1. Rritja e aksesit dhe e disponueshmërisë së mikrofinancës nga grupet e cenueshme, të cilët dëshirojnë të ngrenë ose të zhvillojnë biznesin e tyre dhe të mikrondërmarrjeve;
2. Ndërtimi i kapaciteteve institucionale të ofruesve të mikrokredive;
3. Mbështetja e zhvillimit të ndërmarrjeve sociale në veçanti, duke lehtësuar qasjen në financa.

Për efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje, sqarojmë se vlera prej 50 mijë eurosh, është planifikuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe është akorduar në buxhetin e vitit 2015, si kosto lokale në programin buxhetor “Planifikim, menaxhim dhe administrim”.

Shqipëria duhet të paguajë, për të marrë pjesë në këtë program të BE-së një kontribut financiar për periudhën 2014-2016, një shumë prej 50 mijë eurosh dhe për periudhën 2017-2020, një shumë prej 100 mijë eurosh. Ky kontribut do të mbulojë kostot që lidhen me përgatitjen, fizibilitetin, zhvillimin dhe zbatimin e projekteve me interes të përbashkët, si dhe për zhvillimin dhe zbatimin e masave horizontale, siç janë parashikuar në program. Ky kontribut do të mbulohet, siç e thashë më parë, nga buxheti i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe

Rinisë. Në vitet në vijim, pas miratimit të instrumentit financiar IPA2 nga Komisioni European, Shqipëria do të ketë mundësi rimbursimit deri në 80% të kontributeve të saj financiare.

Faleminderit!

Majlinda Bregu – Faleminderit, juve!

A ka ndonjë pyetje nga kolegët?

Unë e kam shumë të qartë qëllimin, misionin dhe mënyrën si hartohen marrëveshjet kuadër. Thatë që *fee*-në prej 50 mijë eurosh e keni të parashikuar nga buxheti i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Kjo do të thotë që kështu do të vazhdoni dhe për periudhën pasardhëse, sepse deri në momentin e projektit IPA 2, mund të dalë ndonjë marrëveshje tjetër financiare, kështu që do t’ju duhet të parashikoni çdo vit.

Sa akse të marrëveshjes përfiton Shqipëria?

Bardhylka Kospiri – Shqipëria përfiton 2 akse kryesore: aksi “Progres” dhe aksi “Mikrofinanciar dhe ndërmarrje sociale”.

Majlinda Bregu – Besoj se ju keni filluar nga hartimi i strategjisë, si do të zhvillohen në nivel kombëtar, apo jo? Si do të përdoret fondi dhe si do të ndahet, pavarësisht kritereve, që njihet marrëveshja kuadër?

Bardhylka Kospiri – Sigurisht, po.

Majlinda Bregu – Besoj se është shërbimi social.

Bardhylka Kospiri – Shërbimi social dhe punësim.

Majlinda Bregu - A ka ndonjë pyetje nga kolegët? S’ka.

Nuk do të shtojmë vendet e punës për zonat tuaja, sepse marrëveshja ka tjetër qëllim. Gjithsesi, aftësimi është një element kryesor dhe Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit të Kuvendit është shprehur dakord dhe se kjo marrëveshje është në përputhje me MSA-në dhe me Planin Kombëtar për Integrimin European.

Ministria e Integritimit është shprehur dakord. Nuk e kuptoj se përse nuk e kam asnjëherë në tavolinë mendimin me shkrim të Ministrisë së Integritimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Përse nuk e keni sjellë këtë radhë Stela?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ka ardhur me kopjen tuaj. Një njoftim i herëpashershëm i duhet bërë Ministrisë së Integritit, që t'i kujtosh që e ka detyrim ligjor të na sjellë mendimin e saj direkt, dhe jo nëpërmjet ministrisë përgjegjëse.

Duke qenë se është e milionta herë që e diskutojmë këtë çështje...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Meqë Stela e ka me vete, por s'e ka sjellë këtu në komision, do t'u thuash që pa mendimin e tyre me shkrim, të mos sjellin as përfaqësuesin e tyre në komision. I falënderojmë shumë për zemërgjerësinë!

Stela, përcillja edhe drejtoreshës në ministri, mesazhin tonë!

Nuk kemi nevojë për praninë tuaj, pa sjellë mendimin me shkrim këtu.

E hedhim në votim projektligjin.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Për COSAP-in do të flasim me Taulantin. Grupi i maxhorancës i beson fuqishëm Taulantit dhe vendimmarrjes së tij. Opozita besoj se do të më besojë mua.

A jeni dakord me kalendarin e punës së komisionit?

Po patët ndonjë propozim, jepjani Denisit.

MBYLLET MBLEDHJA

Kryetare
Majlinda Bregu

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

